

VENDIM
Nr. 1023, datë 16.12.2020

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, TË PRONËS SHETETËRORE, NË
ZONËN KADASTRALE NR. 8602, NË PRONËSI TË PORTIT DETAR VLORË SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8602, në pronësi të Portit Detar Vlorë sh.a., sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, do të përdoret nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me Planin Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

